

Nr 4980/prot

09.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 998/ Prot.

Fier, më 09.10.2020

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve 72, 75, 76, të Këshillit Bashkiak Roskovec datë 28.09.2020.

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI

KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri HYSKA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 4980 prot. datë 29.09.2020, bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8 shkronja “a” dhe 16 pasi shqyrtoam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 28.09.2020 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet konfirmojmë si më poshtë:

Vendimi Nr. 72 datë 28.09.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për ndryshim dhe disa shtesa në Vendimin Nr. 105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”. Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8 pika 2; neni 9 pika1 nënpika 1.1 shkronja “b”, neni 54 shkronja f; Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113; Ligjin Nr 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6 shkronja “c”; Ligjin Nr 152/2015 “Për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin” si dhe në zbatim të VKM Nr. 607 datë 29.07.2020 “Tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.”

Me Vendimin Nr. 75 datë 28.09.2020 të Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe studimit të fizibilitetit për “Stacion transferimi të mbetjeve në Bashkinë Roskovec” keni miratuar:

Pika 1- Miratimin e “Planit të Menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane”

Pika 2- Miratimin e Studimit të Fizibilitetit për “Stacion Transferimi të Territorit” në Bashkinë Roskovec.

Për sa më sipër ju konfirmojmë se:

- Për pikën 1 të vendimit miratimin e “Planit të Menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane” e cila është me karakter normativ do të shprehemi pasi të njihemi me dokumentin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor bazuar në Ligjin Nr 10463 datë 09.06.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 13, pika 2 dhe 5 dhe Ligjin Nr 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar)
- Pika 2 e vendimit miratimin e Studimit të Fizibilitetit për “Stacion transferimi të territorit” në Bashkinë Roskovec në bazë të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 3 pika 2 nuk është me karakter normativ. Akti normativ në kuptim të ligjit përmban rregulla të detyrueshme sjelljeje për një marrëdhënie juridike ose kompleks marrëdhëniesh juridike të përgjithshme. Ai i drejtohet një kategorie të gjërë subjektesh nuk i referohet një fakti konkret por një numër faktesh të mundshme ose hipotetike si dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Pika 2 e vendimit Nr.75 datë 28.09.2020 nuk plotëson kriteret për tu klasifikuar me karakter normativ Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 8 “Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut” shkronja “a” “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve urdhërave, urdhëresave me karakter normativ të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. Për sa më sipër verifikimi i ligjor i kësaj pike nuk është në kompetencën e prefektit të qarkut.

Vendimi nr. 76 datë 28.09.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nën-pika 1.1 shkronja “b”, neni 54 gërma “dh”. Ligjin Nr 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore” neni 22; Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH” i ndryshuar neni 15; si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALA

